



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PEQIN

Nr. 754 .Prot.

Peqin, më 09.05/2022

VENDIM

Nr. 88 , Datë 09.05 .2022

### “PËR NGRITJEN E KËSHILLIT VENDOR TË RINISË”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Peqin Nr. 18, datë 26.04.2022 “Për krijimin e Këshillit Vendor të Rinisë”;

#### VENDOSA:

1. Të miratojë ngritjen e Këshillit Vendor të Rinisë, me këtë përbërje;

➤ Lorenc	Tosku	Kryetari i Bashkisë Peqin	Kryetar
➤ Raimonda	Zyba	Pergjegjësi i NJKIENH	Anëtar
➤ Doralda	Dushku	Sp./Sekt. Burimeve Njerëzore	Anëtar
➤ Adela	Gripshi	përfaqësues të organizatave rinore	Anëtar
➤ Izabela	Tabaku	përfaqësues të organizatave rinore	Anëtar
➤ Jorken	Sula	përfaqësues të organizatave për të rinjtë	Anëtar

2. Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë Peqin dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:

- këshillon për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin e bashkisë Peqin;
- bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

/ Lorenc TOSKU /

